



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -  
Ministry of Finance, Labour and Transfers  
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
Qeveria Kosovës / Vlada Kosovo / Government of Kosovo  
Ministria e Financave dhe Transfereve / Ministarstvo za Finansije i Transfera  
Ministry of Finance and Transfers  
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosovo / Tax Administration of Kosovo

ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE

Nr. Prot. 01-06.4057  
Prot. No: 14.07.25

Nr. Faqeve / str. / list. / No papers / HYRËSE

Administrata Tatimore e Kosovës

# UDHËZUES NR. 01/2025 PËR PROCEDURAT DHE FORMËN E FISKALIZIMIT TË BLLOKAVE TATIMORË

Me qëllim të zbatimit të dispozitave të përcaktuara sipas nenit 27 dhe nenit 46 të Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr. 01/2025 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale, Sistemeve Fiskale dhe Softuerëve Elektronikë Fiskalë, në përputhje me autorizimet ligjore që disponon sipas nenit 48, paragrafit 1, nën paragrafi 1.12 të Ligjit Nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore, si dhe dispozitave ligjore të nenit 23 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, miraton:

## **UDHËZUES NR. 01/2025 PËR PROCEDURAT DHE FORMËN E FISKALIZIMIT TË BLOKAVE TATIMORË**

### **Neni 1 Qëllimi**

Ky Udhëzues përcakton procedurat dhe formën e fiskalizimit të bllokave tatimorë, në përputhje me nenin 27 dhe 46 të Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr. 01/2025 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale, Sistemeve Fiskale dhe Softuerëve Elektronikë Fiskalë. Gjithashtu, ky Udhëzues synon të sigurojë një proces transparent, efikas dhe të thjeshtë për tatimpaguesit, duke përdorur platformën elektronike, gjegjësisht Sistemin Elektronik EDI të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) për shërbime elektronike.

### **Neni 2 Fushëveprimi**

Ky Udhëzues zbatohet nga:

- Tatimpaguesit që janë të detyruar të lëshojnë kuponë fiskalë nga PEF/SF;
- Tatimpaguesit që janë të detyruar të lëshojnë kuponë fiskalë nga SEF; dhe
- Tatimpaguesit që janë të detyruar të lëshojnë kuponë fiskalë, mirëpo, nuk janë të pajisur me PEF/SF, ashtu siç është e përcaktuar me nenin 51 – Dispozitat kalimtare, të Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr.01/2025.

### Neni 3 Përkufizimet

Për qëllime të këtij Udhëzuesi, termet si në vijim kanë kuptimin përkatës:

1. **Pajisja Elektronike Fiskale / Sistemi Fiskal (PEF/SF)** - pajisja ose sistemi elektronik i kompjuterizuar që shfrytëzohet për të lëshuar kuponët e shitjes për transaksionet me pakicë. PEF/SF përfshin ato pajisje elektronike, si: arkat fiskale, printerët fiskalë dhe sistemet fiskale për veprimtari të veçanta. Një PEF/SF përfshin: memorien fiskale, memorien punuese ditore, softuerin mbështetës (firmware), orën e saktë, mekanizmin e shtypjes së kuponit, si dhe njësitë kontrolluese lidhëse për tastiera, Terminalin Tatimor (TT), Kripto Modulën e Sigurtë për shifrimin e të dhënave (KMS), Kartelën e Memories (KM), Zhurnalën Kontrollues Elektronik - kartelë e memories (ZHKE), ekranet dhe nën-njësitë e transmetimit të të dhënave hyrëse dhe dalëse (sikurse janë skanerët), të cilat duhet të jenë pjesë përbërëse e sistemit. Të gjithë komponentët e ofruar dhe funksionet e PEF/SF aprovohen ose autorizohen nga Divizioni për Arka Fiskale (DAF), ndërsa softueri mbështetës (firmware) ose mekanizmi tjetër verifikues i funksioneve të PEF/SF duhet të jetë në dispozicion të ATK-së;
2. **Softueri Elektronik Fiskal (SEF)** – është softuer elektronik i zhvilluar për të regjistruar dhe raportuar transaksionet financiare të tatimpaguesve në mënyrë të automatizuar dhe në përputhje me legjislacionin tatimor në Republikën e Kosovës. Përmes SEF-it regjistrohen furnizimet e mallrave dhe/ose shërbimeve për transaksionet me pakicë, gjenerohet kuponi fiskal dhe raportohen të dhënat në kohë reale në Sistemin Informativ të ATK-së;
3. **Arka Fiskale** - është regjistruar elektronik i furnizimit të mallrave dhe/ose shërbimeve, arka që janë të pajisura posaçërisht me memorie fiskale, pllombë fiskale dhe mundësi e pajisje tjera, ashtu siç përkufizohen në specifikacionet teknike dhe funksionale të publikuara nga ATK-ja;
4. **Konsumatori i fundit** – nënkupton personin fizik jo afarist, i cili mallrat dhe/ose shërbimet e blera i përdor për nevoja personale. Po ashtu, konsumator i fundit mund të konsiderohet edhe personi fizik afarist, personi juridik, ortakëria dhe grupimi apo shoqëria e personave duke përfshirë konzorciumet dhe autoritetet publike, të cilët mallrat dhe/ose shërbimet e blera i përdorin për nevoja biznesore dhe jo për qëllim të rishitjes apo zhvillimit të aktiviteteve të tyre;
5. **Kuponi fiskal** – është dokument në të cilin regjistrohet furnizimi i mallrave dhe/ose shërbimeve në pikën e shitjes për konsumatorin e fundit. Kuponi fiskal gjenerohet nga PEF/SF/SEF, i cili shtypet në letër apo mund të dërgohet në mënyrë elektronike për furnizime të veçanta (furnizime elektronike). Karakteristikat e veçanta të kuponit fiskal janë: logo fiskale dhe nënshkrimi me 2D barkod (nënshkrimi elektronik i gjeneruar përmes kriptimit të të dhënave në Dokumentin Fiskal - Kodi QR). Karakteristikat e tjera

mund të përcaktohen në dokumentin e kërkesave specifike teknike dhe funksionale për PEF/SF/SEF;

6. **Kodi Unik i Bllokut Tatimor** – është Kod i gjeneruar përmes sistemit elektronik EDI për fiskalizimin e bllokut tatimor. Kodi Unik i Bllokut Tatimor vlen vetëm për një bllok, i cili përmban jo më shumë se 50 kuponë tatimorë. Kodi Unik i Bllokut Tatimor mund gjenerohet varësisht nga kërkesa e tatimpaguesit;
7. **Kuponi tatimor** - është dokument në të cilin regjistrohet furnizimi i mallrave dhe/ose shërbimeve në pikën e shitjes për konsumatorin e fundit. Kuponi tatimor lëshohet në rastet kur PEF/SF/SEF ka prishje të përkohshme, probleme tjera teknike apo nëse ndodh ndërprerja e plotë e punës së pajisjes për zbatimin e fiskalizimit. Gjithashtu, kuponi tatimor është dokument në të cilin regjistrohet furnizimi i mallrave dhe/ose shërbimeve në pikën e shitjes për konsumatorin e fundit nga tatimpaguesit që kërkohet të lëshojnë kuponë fiskalë, mirëpo nuk janë të pajisur me PEF/SF, ashtu siç është e përcaktuar me nenin 51 – Dispozitat kalimtare, të Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr.01/2025. Kuponi tatimor është pjesë e bllokut tatimor, i cili duhet të jetë i fiskalizuar nga ATK, për situata të caktuara.

#### **Neni 4** **Baza Ligjore**

1. Sipas nenit 6, paragrafi 8 të Ligjit Nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore, furnizimet që bëhen për individë duhet të regjistrohen në PEF/SF apo softur dhe të shtypet kuponi fiskal për konsumatorin/klientin, citojmë:

*“8. Të gjithë personat e përfshirë në aktivitete ekonomike, të cilëve ju kërkohet të instalojnë PEF/SF apo software për regjistrimin e transaksioneve që lidhen me aktivitetin e tyre ekonomik, i lëshojnë klientit kupon fiskal që i përmbahet specifikimeve teknike të kuponëve.”*

2. Sipas nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr. 01/2025 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale, Sistemeve Fiskale dhe Softuerëve Elektronikë Fiskalë, janë përcaktuar personat që duhet të lëshojnë kuponë fiskalë, citojmë:

*“1. Të gjithë personat që bëjnë furnizime të mallrave dhe/ose shërbimeve për konsumatorin e fundit, pavarësisht mënyrës së pagesës, lëshojnë kuponë fiskalë për ato furnizime.*

*2. Pavarësisht paragrafit 1 të këtij neni, personi i cili ofron falas furnizime të mallrave dhe/ose shërbimeve për konsumatorin e fundit, për qëllime tatimore, obligohet të lëshojë kupon fiskal për atë furnizim.*

3. Përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, të gjithë personat që bëjnë furnizime të mallrave dhe/ose shërbimeve për personin fizik afarist, personin juridik dhe personat e tjerë (përveç konsumatorit të fundit kur duhet t'i lëshojnë kupon fiskal) përdorin faturën tatimore, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin tatimor në fuqi.

4. Ministri përkatës për Financa, përveç përjashtimeve të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, me vendim të veçantë mund të përjashtojë nga detyrimi për lëshimin e kuponit fiskal edhe ndonjë kategori tjetër të tatimpaguesve”.

3. Sipas nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr. 01/2025 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale, Sistemeve Fiskale dhe Softuerëve Elektronikë Fiskalë, është përcaktuar momenti i lëshimit të kuponit fiskal, citojmë:

“1. Printimi dhe dhënia e kuponit fiskal për konsumatorin, është i detyrueshëm në momentin e pagesës së furnizimit me mall dhe/ose shërbim.

2. Printimi dhe dhënia e kuponit fiskal për konsumatorin, është i detyrueshëm edhe për çdo pagesë të bërë përpara kryerjes së furnizimit të mallrave, ose përpara përfundimit të furnizimit të shërbimeve.

3. Në përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, në rastet kur ndodh furnizimi me mall dhe/ose shërbim, mirëpo pagesa bëhet më vonë (me afat pagese) sipas dakordimit të dy palëve, printimi dhe dhënia e kuponit fiskal për konsumatorin është i detyrueshëm në momentin e furnizimit të mallit dhe/ose shërbimit.”

4. Sipas nenit 7 të Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr. 01/2025 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale, Sistemeve Fiskale dhe Softuerëve Elektronikë Fiskalë, është përcaktuar përmbajtja e kuponit fiskal, citojmë:

“1. Kuponi fiskal përpilohet duke u bazuar në kërkesat specifike dhe teknike për PEF/SF/SEF, të aprovuara nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së.

2. Kuponi fiskal përmban, të paktën, informacionet e mëposhtme:

2.1. Numrin Unik Identifikues/Numrin Fiskal të tatimpaguesit;

2.2. Numrin e TVSH-së, nëse tatimpaguesi është i regjistruar për TVSH;

2.3. Emrin e tatimpaguesit;

2.4. Adresën e tatimpaguesit;

2.5. Emrin e personit (operatorit) dhe numrin identifikues të tij;

2.6. Së paku një rresht për secilin artikull:

2.6.1. sasia;

2.6.2. çmimi për njësi;

2.6.3. emrin e artikullit apo shërbimit;

2.6.4. vlerën e sasisë së furnizimit;

2.6.5. normën përkatëse të TVSH-së të shënuar me një shkronjë specifike për çdo artikull të furnizuar;

2.7. Përqindjen (apo vlerën) e zbritjes dhe shumën e saj me shenjën minus, apo përqindjen (vlerën) e rritjes, nëse ka për artikull;

- 2.8. Shumën e nën-totalit, përqindjen (apo vlerën) e zbritjes mbi të dhe shumën e saj me shenjë minus, përqindjen (apo vlerën) tepricë, nëse ka;
- 2.9. Shumën totale për pagesë;
- 2.10. Shumën e paguar në mënyra të ndryshme të pagesës, si: para të gatshme (kesh), kredit kartelë, debit kartelë, llogari bankare, kupon shpërblyes (vauçer), çek, SMS, etj.;
- 2.11. Shumën e tatimit sipas normave të ndryshme aktive tatimore;
- 2.12. Shumën totale pa tatim;
- 2.13. Datën, orën dhe minutat e lëshimit;
- 2.14. Numrin identifikues të PEF/SF/SEF;
- 2.15. Numrin ditor të kuponit fiskal;
- 2.16. Kodin QR;
- 2.17. Numrin Unik Identifikues të Kuponit Fiskal (për verifikim të kuponit fiskal);
- 2.18. Logon – RKS;
- 2.19. Tipin e kuponit (i rregullt, anulim, kthim malli, etj.); dhe
- 2.20. Tekstin e lirë, etj.”

5. Sipas nenit 27 të Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr. 01/2025 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale, Sistemeve Fiskale dhe Softuerëve Elektronikë Fiskalë, është përcaktuar shfrytëzimi i kuponit tatimor, citojmë:

*“Në rast të prishjes së përkohshme apo problemeve tjera teknike të PEF/SF, shfrytëzuesi është i detyruar të lëshojë një kupon të shkruar tatimor për çdo shitje të bërë. Nga ATK-ja do të miratohet blloku tatimor (në formë fizike apo elektronike), i cili përmban numrat serikë. Për të gjithë kuponët tatimorë të lëshuar gjatë shitjes, si rezultat i prishjes apo problemeve teknike të PEF/SF, bëhet një raport me shkrim. Pas evitimit të prishjes apo problemit të PEF/SF, përdoruesi menjëherë e kthen atë në punë. Detajet lidhur me kuponin tatimor përcaktohen nga ATK-ja.”*

6. Sipas nenit 46 të Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr. 01/2025 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale, Sistemeve Fiskale dhe Softuerëve Elektronikë Fiskalë, është përcaktuar procedura e fiskalizimit të bllokut tatimor, citojmë:

*“1. Nëse ndodh ndërprerja e plotë e punës së pajisjes për zbatimin e fiskalizimit, tatimpaguesi që lëshon kuponë fiskalë, lëshon një kupon fiskal nga një bllok i veçantë i kuponëve fiskalë.*

*2. Tatimpaguesi që lëshon kuponë fiskalë, duhet të fiskalizojë bllokun e veçantë të kuponëve fiskalë në ATK.*

*3. Blloku i veçantë i kuponëve fiskalë duhet të ketë numër serik të printuar për çdo kupon fiskal që përmban.*

*4. Blloku i veçantë i kuponëve fiskalë përmban dy kopje për secilin kupon: origjinalin për konsumatorin dhe kopjen që mbetet te furnizuesi i mallit dhe/apo shërbimit.*

*5. Në rastin e referuar në paragrafin 1 të këtij neni, tatimpaguesi që lëshon kuponë fiskalë, detyrohet që brenda dyzet e tetë (48) orëve, nga momenti kur pajisja ka ndaluar*

*plotësisht së funksionuari, të mundësojë funksionimin e pajisjes për lëshimin e kuponëve fiskalë ose të sigurojë një pajisje të re.*

*6. Brenda pesë (5) ditëve pas afatit të përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni, tatimpaguesi që lëshon kuponë fiskalë sipas paragrafit 1 të këtij neni, detyrohet t'i regjistrojë të gjithë kuponët fiskalë në SEF, të cilët dërgohen në mënyrë automatike në Sistemin Informativ të ATK-së.”*

## **Neni 5**

### **Fiskalizimi i bllokave tatimorë**

Tatimpaguesit të cilët nuk janë të pajisur me PEF/SF nga data e hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr. 01/2025 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale, Sistemeve Fiskale dhe Softuerëve Elektronikë Fiskalë, nuk janë të obliguar për t'u pajisur me PEF/SF, por janë të obliguar që brenda periudhës së përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 51 – Dispozitat kalimtare, të instalojnë dhe përdorin SEF-in. Brenda kësaj periudhe, këta tatimpagues kërkohe të përdorin kuponët tatimorë të fiskalizuar në ATK.

Në rast të prishjes së përkohshme, problemeve tjera teknike të PEF/SF, apo nëse ndodh ndërprerja e plotë e punës së pajisjes për zbatimin e fiskalizimit, tatimpaguesi që kërkohe të lëshojë kuponë fiskalë, duhet të lëshojë një kupon tatimor nga një bllok i veçantë i kuponëve tatimorë.

Në rastet e cekura më lart në këtë nen, tatimpaguesi i cili detyrohet të lëshojë kuponë tatimorë në vend të kuponit fiskal të gjeneruar nga PEF/SF/SEF, paraprakisht duhet të fiskalizojë bllokun e veçantë të kuponëve tatimorë në ATK.

Blloku i veçantë i kuponëve tatimorë i cili kërkohe të fiskalizohet nga ATK, duhet të ketë numër serik të printuar, për çdo kupon tatimor që përmban. Gjithashtu, ky bllok përmban dy kopje për secilin kupon: origjinalin për konsumatorin dhe kopjen që mbetet te furnizuesi i mallit dhe/apo shërbimit.

Tatimpaguesi që lëshon kuponë fiskalë, detyrohet që brenda dyzet e tetë (48) orëve, nga momenti i prishjes së përkohshme, problemeve tjera teknike, apo kur pajisja ka ndaluar plotësisht së funksionuari, të mundësojë funksionimin e pajisjes për lëshimin e kuponëve fiskalë ose të sigurojë një pajisje të re.

Brenda pesë (5) ditëve pas afatit dyzet e tetë (48) orësh, tatimpaguesi që lëshon kuponë tatimorë nga një bllok i veçantë i kuponëve tatimorë, detyrohet t'i regjistrojë të gjithë kuponët tatimorë në SEF, të cilët dërgohen në mënyrë automatike në Sistemin Informativ të ATK-së.

Gjithashtu, brenda pesë (5) ditëve pas afatit dyzet e tetë (48) orësh, tatimpaguesi që lëshon kuponë tatimorë nga një bllok i veçantë i kuponëve tatimorë, detyrohet të bëjë një raport me

shkrim për të gjithë kuponët tatimorë të lëshuar gjatë shitjes, si rezultat i prishjes apo problemeve teknike të PEF/SF.

Përfundim nga tatimpaguesit që obligohen të fiskalizojnë bllokat tatimorë, tatimpaguesit që operojnë në sektorë të veçantë të ekonomisë dhe kryejnë shitje përmes makinave të vetëshërbimit (automat), nëse pajisja e vetëshërbimit ka një ndërprerje të përkohshme në shërbimin e komunikimit me Sistemin Informativ të ATK-së, tatimpaguesi që lëshon kupon fiskalë nuk obligohet të fiskalizojë bllokun tatimor, por duhet të sigurojë ruajtjen e të dhënave në shitje dhe të kryejë procedurën e fiskalizimit, pas eliminimit të problemit ose lidhjes së rivendosur, brenda dyzet e tetë (48) orëve.

## **Neni 6**

### **Procedura e fiskalizimit të bllokave tatimorë**

Blloku i veçantë i kuponëve tatimorë konsiderohet i fiskalizuar vetëm pas pajisjes me Kod Unik të Bllokut Tatimor, i cili gjenerohet përmes Sistemit Elektronik EDI.

Për t'u pajisur me Kod Unik të Bllokut Tatimor, tatimpaguesi duhet të kyçet në Sistemin Elektronik EDI, tek menyja "Shërbimet" dhe të plotësojë formën e kërkesës për gjenerimin e Kodit Unik të Bllokave Tatimorë.

Kodi Unik i Bllokut Tatimor vlen vetëm për një bllok tatimor i cili i përmban jo më shumë se pesëdhjetë (50) numra serik të kuponëve tatimorë. Nëse tatimpaguesi duhet të lëshoj më shumë se pesëdhjetë (50) kuponë tatimorë, atëherë duhet të gjeneroj kod të ri unik për bllokun e ri tatimor.

## **Neni 7**

### **Fiskalizimi i bllokave tatimorë në formë elektronike**

Fiskalizimi i bllokave tatimorë atëherë kur kërkohet, bëhet në mënyrë elektronike përmes Sistemit Elektronik EDI, si në vijim:

1. Tatimpaguesi i cili përdor Softuerin Elektronik Fiskal (SEF) për lëshimin e kuponit fiskal duhet të plotësojë formën e kërkesës për gjenerimin e Kodit Unik të Bllokut Tatimor, e cila duhet t'i përmbajë informatat si në vijim:
  - Njësia e biznesit;
  - Data e fillimit të ndërprerjes;
  - Statusi i tatimpaguesit:
    - o Tatimpagues që lëshon kuponë fiskalë nga SEF;
  - Fillimi i numrit rendor të kuponëve tatimorë;
  - Mbarimi i numrit rendor të kuponëve tatimorë.

Kuponët nga blloku i kuponëve tatimorë do të vazhdojnë numrin rendor që fillon pas numrit të kuponit të fundit të lëshuar nga SEF. Kur tatimpaguesi rifillon të lëshojë kuponë nga SEF, ai duhet të vazhdojë numërimin rendor që fillon pas numrit të kuponit të fundit të lëshuar nga blloku i kuponëve tatimorë gjatë periudhës së mosfunksionimit të pajisjes.

- Arsyeja e gjenerimit të Kodit Unik të Bllokut Tatimor:
    - o Ndërprerje e plotë e punës së pajisjes.
  - Kodi Unik të gjeneruar nga Sistemi.
2. Tatimpaguesi i cili nuk është i fiskalizuar në datën e hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr.01/2025 ashtu siç është e përcaktuar me nenin 51 – Dispozitat kalimtare dhe tatimpaguesi i cili përdor PEF/SF për lëshimin e kuponit fiskal duhet të plotësoj formën e kërkesës për gjenerimin e kodit unik e cila duhet t'i përmbajë informatat si në vijim:
- Njësia e biznesit;
  - Data e fillimit të ndërprerjes;
  - Statusi i tatimpaguesit:
    - o Tatimpagues i pa fiskalizuar sipas nenit 51 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2025;
    - o Tatimpagues që lëshon kuponë fiskalë nga PEF/SF;
  - Fillimi i numrit rendor të kuponëve tatimorë sipas bllokut;
  - Mbarimi i numrit rendor të kuponëve tatimorë sipas bllokut;
  - Arsyeja e gjenerimit të Kodit Unik të Bllokut Tatimor:
    - o Prishje e përkohshme;
    - o Probleme teknike e PEF/SF, apo
    - o Ndërprerje e plotë e punës së pajisjes.
  - Kodi Unik të gjeneruar nga Sistemi.

## **Neni 8**

### **Përmbajtja e kuponit tatimor**

Kuponi tatimor përmban, të paktën, informacionet e mëposhtme:

- Numrin Unik Identifikues/Numrin Fiskal të tatimpaguesit;
- Numrin e TVSH-së, nëse tatimpaguesi është i regjistruar për TVSH;
- Emrin e tatimpaguesit;
- Adresën e tatimpaguesit/Njësisë;
- Kodin Unik të Bllokut Tatimor;
- Numrin serik të kuponit tatimor;
- Së paku një rresht për secilin artikull:
  - o nr. rendor;

- përshkrimi i mallrave dhe/ose shërbimeve;
- njëësia matëse;
- sasia;
- çmimi për njësi;
- vlera totale;
- Totali i TVSH-së sipas normave tatimore, nëse aplikohet;
- Shumën totale për pagesë – Totali, me TVSH për furnizimet e transaksioneve për klient;
- Tipi i kuponit (i rregullt, anulim, kthim i mallit);
- Tekstin: ndërprerje e punës së pajisjes fiskale (PEF/SF/SEF).

**Neni 9**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzues hynë në fuqi në datën e nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK- së, ndërsa zbatimi i tij fillon nga data 21.07.2025.

Data: 14 / 07 / 2025

Ilir Murtezaj



U.d. Drejtor i Përgjithshëm i ATK-së